REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS-MINISTARSTVO OBRAZOVANJA I NAUKE-MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE
DALJE
Njësia org. 2/IK Data/Datum/Date 120826
Nr. Prot./Br./No 4094 Nr. i faq./Br.str/No pg 2
Prishtinë / Priština / Pristina

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada – Government***

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës/*
*Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science*

**Nr.** 2/IK-4094
**Datë: 12.08.2026**

Komisioni për trajtimin e ankesave për bursa, grante dhe mbështetje financiare, në bazë të vendimit nr. 2-1319 të datës 30.03.2026, vendimit nr. 2-3736 të datës 29.07.2026 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 2-1319 të datës 30.03.2026 dhe bazuar në nenet 37, 83, 124, 125 dhe 129 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.20/21, qershor 2016, Prishtinë), në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 20/2023 për krijimin e skemave për mbështetje financiare të studentëve për ndarjen e bursave dhe konkursit të datës 08.06.2026 për ndarjen e bursave STEM në programet baçelor për studentet vajza/gra, në vitin akademik 2025/2026, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Refuzohen si të pabazuara ankesat e studenteve sipas konkursit të datës 08.06.2026 për ndarje të bursave STEM në programet baçelor për vajza/gra, në vitin akademik 2025/2026, si më poshtë:

   1.1.MASH-STEM-00754, nr. prot.. 3280-(nuk ka provime të vitit akademik 2025/26 sipas kritereve të konkursit).
   1.2.MASH-STEM-00751, nr. prot, 3345-(nuk i plotëson kriteret sipas konkursit, ka vetëm një provim të dhënë në vitin akademik 2025/26).
   1.3.MASH-STEM-00771, nr. prot. 3347-(nuk i plotëson kriteret sipas konkursit për shkak se nuk posedon provime në vitin akademik 2025/26).
   1.4.MASH-STEM-00291, nr.prot.3383- (nuk i plotëson kriteret sipas konkursit, nuk posedon provime në vitin akademik 2025/26 dhe ka dorëzuar një certifikatë të notave pa vulë dhe protokoll ).
   1.5.MASH-STEM-00427, nr. prot. 3386-(nuk i plotëson kriteret sipas konkursit, është evidentuar data e provimit të dhënë para regjistrimit në vitin akademik 2025/26).
   1.6.MASH-STEM-00832, nr. prot. 3436-(nuk i plotëson kriteret sipas konkursit për shkak se deri në mbyllje të afatit të konkursit për aplikim nuk ka pasur provime të dhëna)
   1.7.MASH-STEM-00728, nr. prot. 3490-(nuk i plotëson kriteret sipas konkursit, për shkak se viti akademik i regjistrimit është 2024/2025).

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Komisioni për trajtimin e ankesave për bursa, grante dhe mbështetje financiare në MASH, pas shqyrtimit të ankesave të parashtruara dhe dëshmive të pranuara nga komisioni paraprak vlerësues, konstaton se ankesat e studentëve të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, janë të pabazuara sipas kushteve dhe kritereve të konkursit të datës 08.06.2026 për ndarje të bursave STEM në programet baçelor për studentet vajza/gra në vitin akademik 2025/2026.
Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike**: Vendimi është përfundimtar në procedurë administrative, ndërsa ankuesi mund të iniciojë konflikt administrativ konform legjislacionit në fuqi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Të lartpërmendurve;
2. DALSH/MASH;
3. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm në MASH;
4. Komisionit për trajtimin e ankesave;
5. Arkivit në MASH.

Muhabere Maliqi

Kryetare e komisionit